



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**

**KUVENDI**

***Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut***

Tiranë, më 11.2.2019

**RAPORT**

**PËR PROJEKTLIGJIN**

**“PËR RATIFIKIMIN E PROTOKOLLIT**

**TË TRAKTATIT TË ATLANTIKUT VERIOR PËR ADERIMIN**

**E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT”**

**- HYRJE**

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi, në mbledhjen e datës 11 shkurt 2019, mori në shqyrtim projektligjin “Për ratifikimin e protokollit të Traktatit të Atlantikut Verior për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut”. Komisioni caktoi si relator për shqyrtimin e këtij projektligji deputetin Bashkim Fino. Komisioni e shqyrtoi projektligjin në zbatim të neneve 32-38 të Rregullores së Kuvendit.

Për të paraqitur projektligjin, në mbledhjen e Komisionit ishin të pranishëm përfaqësues të Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme, dhe të Ministrisë së Mbrojtjes.

**- BAZA KUSHTETUESE E PROJEKTLIGJIT**

Projektligji, nismë e Këshillit të Ministrave, është bazuar në nenet 81, pika 1, dhe 121 të Kushtetutës, si dhe në nenin 17 të ligjit nr.43/2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit:

*“Neni 17*

*Ratifikimi*

*1. Ratifikimi është akti, me anë të të cilit Republika e Shqipërisë shpreh pëlqimin për të qenë e lidhur nga një marrëveshje ndërkombëtare e nënshkruar më parë prej saj...”*

## - QËLLIMI DHE PËRMBAJTJA E PROJEKTLIGJIT

Projektligji synon ratifikimin e protokollit të Traktati i Atlantikut të Veriut për aderimin e Republikës së Maqedonisë së Veriut në NATO.

Ftesa për anëtarësim erdhi në vlerësim të vullnetit të vazhdueshëm politik të Republikës së Maqedonisë së Veriut për t'u anëtarësuar në NATO, reformave të ndërmarra nga ky vend në rrugën drejt anëtarësimit, angazhimit të këtij vendi për përballimin e sfidave të sigurisë si dhe angazhimit për të plotësuar kushtin e vendosur 10 vite më parë në Samitin e Bukureshtit për të gjetur një zgjidhje të përbashkët me Greqinë për çështjen e emrit.

Qeveritë e Greqisë dhe të Maqedonisë të përfaqësuara nga kryeministrat Tsipras dhe Zaev ranë dakord, me Marrëveshjen e Prespës të datës 17 qershor 2018, për të pranuar emrin 'Maqedonia e Veriut'.

Pas nënshkrimit të marrëveshjes, vendet anëtare të NATO-s vendosën në takimin e krerëve të shteteve dhe qeverive të vendeve anëtare të Aleancës, të mbajtur më 11-12 korrik 2018, që t'i akordojnë zyrtarisht Republikës së Maqedonisë së Veriut ftesën për t'u anëtarësuar në NATO.

Marrëveshja e Prespës u pasua nga referendumi kombëtar në Maqedoni, i zhvilluar mes polemikave dhe pjesëmarrjes së ulët të votuesve, dhe më pas nga ratifikimi i marrëveshjes në parlamentet e të dy vendeve, (respektivisht në 11 janar 2019 në Maqedoni, dhe në 25 janar 2019 në Greqi).

Me ratifikimin e marrëveshjes së Prespës, Zyra Ligjore e Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s hartoi protokollin mbi anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, i cili u është shpërndarë vendeve anëtare të NATO-s për ndjekjen e procedurave të brendshme para nënshkrimit.

Protokolli mbi anëtarësimin e Maqedonisë së Veriut në NATO, u nënshkrua më 6 shkurt 2019 nga të plotfuqishmit e 29 vendeve anëtare në NATO, dhe pritet ratifikimi nga parlamentet e këtyre vendeve si dhe Parlamenti i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Me ratifikimin e protokollit në mënyrë unanime nga të gjithë vendet, mundësohet që Maqedonia e Veriut të bëhet anëtar i 30-të i NATO-s.

*Në përfundim*, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, pasi vlerësoi se:

**-Në aspektin ligjor** projektligji është në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi;

**-Në aspektin procedural,** projektligji është paraqitur në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit;

dhe pasi e shqyrtoi projektligjin në parim, nen për nen dhe në tërësi, e miratoi atë unanimitisht me votat e të gjithë anëtarëve të pranishëm, dhe vendosi t’ia kalojë për miratim seancës plenare.

**RELATOR**

**Bashkim FINO**

**KRYETARI**

**Ulsi MANJA**